



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.03.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:39 dhe mbaroi në orën 14:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës online*:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)*
10. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Fax News.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit do të merren në shqyrtim katër çështje.

Nëse jemi dakord, atëherë pa humbur kohë fillojmë me çështjen e parë. Relator është zoti Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Paraqes projektvendimin bashkë me relacionin përkatës “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”.

Me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në fushën e të drejtës penale.

Me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në fushën e të drejtës penale.

Në këto procedura të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës e Gjykatën e Apelit Korçë (tashmë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm), afati i kandidimit ishte përcaktuar dy javë nga dita e njoftimit.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin si më sipër, ka kandiduar gjyqtarja znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Më datë 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 Këshilli vendosi fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500, nr. 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022, përfshirë edhe për

kandidaten znj. {...}. Në këtë rast, për realizimin e procedurës së verifikimit të kandidates në fjalë, me short, si relator, u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Alban Toro. Bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të përmendur më lart, si dhe pikën 9, të vendimit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2023, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidates në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten Këshilli, me Vendimin nr. 206, datë 26.04.2023, vendosi:

Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504 datë 21.11.2022.”

Në përfundim të procedurës, për kandidaten znj. {...} në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës, të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin përmendur më lart, Këshilli me vendimin nr. 280, datë 25.05.2023, ka vendosur:

1.Kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

2.Vendimi nr. 206, datë 26.04.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Me vendim nr.334 datë 21.06.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 48, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, vendosi:

“1.Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e

Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes, ku u caktova unë si anëtar i Këshillit.

Kandidatja znj. {...}, me kërkesën e datës 29.02.2024 protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} Prot., parashtrori kërkesën për heqje dorë nga kandidimi, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se heq dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë penal, të shpallur në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 503 datë 21.11.2022.

Në rrethanat sa sipër, duke marrë në konsideratë kërkesën e heqjes dorë, ne si komision i propozojmë Këshillit përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi diskutime?

Nëse jo, kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi projektvendimin sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.03.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 499, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:39 dhe mbaroi në orën 14:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës online*:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)*</i> |
| <i>10. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
- 7. Fax News.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 499, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër, i cili është edhe kjo heqje dorë.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Meqenëse është e njëjta situatë, unë po mundohem t’i paraqes në mënyrë më të përmbledhur relacionet e tjera pasi i përkasin të njëjtës situatë.

Është paraqitur një kërkesë për tërheqje nga kandidimi i zotit {...} në procedurën

e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022.

Zoti {...} e ka paraqitur dy herë kërkesën. Komunikimi i fundit elektronik është i datës 1.03.2024, i cili ka konfirmuar edhe një herë vullnetin e mëparshëm të paraqitjes së kërkesës me shkrim për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin e shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 499.

Ndodhur në këto kushte, meqenëse kandidati ka tërhequr kandidaturën e tij për pozicionin nr. 499, datë 21.11.2022, ne si Komision i propozojmë Këshillit që të përfundojë procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të tërheqjes nga kandidimi të kandidatit për këtë pozicion, z. {...}.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.03.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:39 dhe mbaroi në orën 14:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)*
10. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Fax News.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatën znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Është e njëjta situatë, në këtë rast kandidatja është znj. {...}, e cila ka paraqitur një kërkesë për tërheqjen e saj nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023.

Meqenëse vetë zonja {...} ka paraqitur një kërkesë për heqje dorë, në të njëjtën

situatë siç e përmenda edhe në rastin e dy kandidatëve të tjerë, Komisioni, ndodhur para të njëjtave kushteve ligjore dhe përpara të njëjtave situata faktike, i propozon Këshillit që edhe në këtë rast të përfundojë procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet sipas propozimit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.03.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 73, nr. 74, nr. 75, nr. 76, nr. 77, nr. 78, nr. 79, nr. 80, nr. 81, nr.82, nr.83, nr. 84 nr. 85 dhe nr. 86, datë 20.02.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:39 dhe mbaroi në orën 14:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës online*:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar)* |
| 9. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Emona Muçi.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.**
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.**
- 7. Fax News.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 73, nr. 74, nr. 75, nr. 76, nr. 77, nr. 78, nr. 79, nr. 80, nr. 81, nr.82, nr.83, nr. 84 nr. 85 dhe nr. 86, datë 20.02.2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër. (*Ka ndërprerje të audios*)

Naureda Llagami: Atëherë, ndjesë se patëm probleme me sistemin.

Kalojmë në aktin e fundit që ka të bëjë me miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës.

Zonja Muçi ka dalë nga mbledhja plenare për shkak se unë i kam miratuar kërkesën për dorëheqjen në shqyrtimin e këtyre pozicioneve.

Kështu që unë, pa humbur kohë kërkoj t'ia jap fjalën zonjës Plaku për të relatuar projekt-aktin.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju parashtoj në mënyrë të përmbledhur dhe do vë theksin vetëm në disa gjëra që duhen të theksohen lidhur me këtë projekt-raport, duke qenë se ju jeni njohur paraprakisht mbi këtë relacion.

Relacion mbi projektvendimin për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73 deri në nr. 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli me vendimet nr.73 deri në nr.81, datë 20.02.2024 ka hapur 9 (nëntë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga të cilat 6 (gjashtë) pozicione civile dhe 3 (tre) pozicione.

Gjithashtu me vendimet nr.82, nr.83, nr.84 nr.85 dhe nr.86 datë 20.02.2024 ka hapur 5 (pesë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, 2 (dy) në fushën penale dhe 3 (tre) në fushën civile.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për secilin nga pozicionet e mësipërme, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, rezulton të kenë kandiduar gjyqtarët sipas tabelës së mëposhtme:

Konkretisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kanë kandiduar 39 kandidatë, ndërsa për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kanë kandiduar 20 kandidatë.

Në zbatim të nenit 43 të ligjit “Për statusin”, si dhe vendimit nr. 320 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, për çdo pozicion të lirë të shpallur, fillon për gjyqtarët kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike profesionale. Në rast se për pozicionin konkret nuk ka kandidatë të tillë, ata janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për mosplotësim kushtesh, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim, e në mungesë edhe të këtyre të fundit, vijon me kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim. Për të bërë të mundur në veçanti gjyqtarët që “mund të kenë 2 vlerësime, 1 vlerësim, ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, në pikën 9 të çdo vendimi hapje procedure lëvizje paralele, Këshilli ka parashikuar se: “Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës, pasi verifikoi përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë si më sipër dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, sipas skemës së re të vlerësimit të Gjyqtarëve, vlerësime të mbaruara, atyre në proces të filluara ose që mund të fillonin sipas programit të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, si dhe bazuar në detyrimin e parashikuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263/2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” për fillimin e procedurës së vlerësimit të përsheptuar të detyruar për gjyqtarët që kanë aplikuar në rastin konkret për lëvizje paralele, vlerëson se:

- Mundësia e pasjes së dy apo të një vlerësimi, evidentohet referuar programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, pjesë e të cilëve janë: gradimet; vlerësimet periodike 3/vjeçare si dhe vlerësimet e përsheptuara në rastet kur gjyqtarët kandidojnë për lëvizje paralele. Hapja e procedurave për lëvizje paralele nuk nënkupton dhe as

kërkon sipas ligjit miratimin e programeve të posaçme të vlerësimit për të gjithë gjyqtarët kandidatë;

- Referuar neneve 43, 84 dhe 171 të ligjit “Për statusin”, i ndryshuar, si dhe vendimit të KLGJ nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjeve paralele”, për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më shumë se 1 vit punë si gjyqtar, vlerësimi i parë konsiderohet ai i gradimit. Për këta gjyqtarë, për efekt të pasjes së dy vlerësimeve, në rast se nuk kanë qenë në programet e vlerësimit, do bëhet vlerësimi i fundit i përsheptuar, ai i vitit 2023, për sa kohë që procedura u hap në 2024;

- Për gjyqtarët që e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më pak se 1 vit punë si gjyqtar, vlerësimi i parë konsiderohet ai periodik 3-vjeçar i filluar ose që mund të fillojë, sipas programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli. Për këta gjyqtarë vlerësimi i dytë do të konsiderohet ai i përsheptuar i detyruar për vitin kalendarik 2023. Por ky i fundit do të konsiderohet i mundshëm për t’u kryer vetëm në rastin kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, në këtë rast nga viti 2019 apo viti 2020.

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, por që nuk janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj për këta gjyqtarë vlerësimi i parë do të konsiderohet vlerësimi i fundit etik dhe profesional që ka qenë në fuqi përpara ligjit “Për statusin”. Për këta gjyqtarë vlerësimi i dytë do të konsiderohet ai i përsheptuar i detyruar për vitin kalendarik 2023.

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional sipas rregullave që kanë qenë në fuqi përpara ligjit “Për statusin”, por që janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj vlerësimi parë do të konsiderohet ai periodik, sipas programit të vlerësimeve për vitin 2021, që i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019, dhe sipas programit të vlerësimeve për vitin 2023, që janë miratuar në 2023 dhe në 2024. Për gjyqtarët e përfshirë në programin e vlerësimeve 2017-2019 apo ato të përfshirë në vitin 2018-2020, vlerësimi i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përsheptuar i detyruar për vitin kalendarik 2023, vlerësim që Këshilli ka marrë përsipër

të kryejë në rastet kur kandidohet për lëvizje paralele.

- Për gjyqtarët e emëruar nga KLGJ, për të cilët verifikimi i pasurisë e figurës është bërë prej tij, vlerësim i parë etik–profesional i mundshëm për t’u kryer, do të konsiderohet ai i parashikuar në programin e vlerësimit për vitin 2023 dhe 2024.

Bazuar në kriteret e mësipërme, lidhur me vlerësimet e kryera e mundësinë e kryerjes së tyre sipas skemës së re të vlerësimit, për secilin gjyqtar në veçanti, konkludohet si më poshtë:

Më poshtë janë përshkruar dhe janë gjithsej 49 kandidatë që kanë aplikuar. Shkurtimeisht po i citoj për secilin prej tyre. Janë marrë sipas rendit që janë vënë në dispozicion nga KZHK-ja.

1. {...}, emëruar në 2022 dhe nuk ka periudhë 3-vjeçare.
2. {...}, është emëruar gjyqtare në 2020, është pjesë e programit.

(Meqenëse anëtarët janë njohur me relacionin dhe konkluzionet për secilin gjyqtar nominalisht, zonja Plaku parashtron vetëm ato raste që mund të kenë diskutime nga mbledhja plenare.)

Për gjyqtaren {...}, e cila është emëruar në 2014, rezulton se ajo mund të ketë vetëm një vlerësim. Periudha e gradimit është vendosur mbas fillimit. Është pjesë e programit dhe është vlerësuar për vitin 2017-2019. Nuk mund t’i bëhet vlerësim i përshpejtuar për shkak se ka qenë me leje lindje.

Për gjyqtarin {...}, në kushtet kur ky i fundit ka paraqitur edhe një kërkesë me shkrim për të cilën unë jam në dijeni. Kam arsyetuar se ky i fundit mund të ketë vetëm një vlerësim për sa kohë që është përfshirë në programin e vlerësimit për vitin 2024, për periudhën e vlerësimit 2020-2022. Më pas është komanduar në Ministrinë e Drejtësisë. Viti i fundit i tij, domethënë nuk mund t’i bëhet vlerësim i përshpejtuar sepse nuk ka dy vjet eksperiencë pas kalimit të vlerësimit të parë i cili është në vitin 2022. Gjithsesi, ndër të tjera, ligji “Për statusin ka parashikuar vlerësime trevjeçare dhe ky i fundit nuk e ka plotësuar periudhën trevjeçare të vlerësimit.

Për sa i përket gjyqtarit {...}, ai është pjesë e programit të vlerësimit periodik të vitit 2020-2023, duke qenë se është emëruar në tetor 2020 dhe ka një vit eksperiencë pune pra Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Më pas

është miratuar leja për ushtrimin e detyrës jashtë funksionit.

Në relacion janë parashikuar të gjithë gjyqtarët dhe arsyet pse mund të kenë apo s'mund të kenë vlerësime, dhe sa vlerësime kanë.

Në përfundim, Komisioni ka miratuar listat përkatëse, konkretisht listat e gjyqtarëve që kanë dy vlerësime, konkretisht (janë marrë sipas alfabetit):

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (ka dy vlerësime); 2. Z. {...} (ka dy vlerësime të miratuara nga Këshilli); 3. Z. {...}, (ka dy vlerësime të miratuara nga Këshilli, një trevjeçar dhe një të përshpejtuar); 4. Znj.{...}, (ka dy vlerësime të miratuara nga Këshilli);

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë dy vlerësime janë:

1. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; 2. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë/ aktualisht i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; 3. Z.{...}; 4. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier/*(aktualisht i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë)*; 5. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; 6. Znj.{...}; 7. Znj.{...}; 8. Z.{...}; 9. Znj. {...};

Lista tjetër është lista e gjyqtarëve që kanë dhe mund të kenë një vlerësim.

Kanë 1 (një) vlerësim:

1. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. 2. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. (të cilat janë miratuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor).

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim, konkretisht janë gjyqtarë të miratuar në programin e vlerësimeve të vitit 2023 dhe në 2024:

1. Znj.{...}; 2. Z.{...}; 3. Znj.{...}; 4. Z.{...}; 5. Znj.{...}; 6. Z.{...}; 7. Z. {...}; 8. Z. {...}; 9. Znj. {...}; 10. Z. {...}; 11. Z.{...}; 12. Z.{...}; 13. Z. {...}; 14. Znj. {...}; 15. Znj. {...}; 16. Znj. {...}; 17. Z. {...}; 18. Znj. {...}; 19. Znj. {...}; 20. Znj. {...}; 21. Z. {...}; 22. Z. {...}.

Ndërsa lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim janë si

më poshtë:

1. Znj. {...}; 2. Z. {...}; 3. Znj. {...}; 4. Znj. {...}; 5. Znj. {...}; 6. Znj. {...}; 7. Znj. {...}; 8. Znj. {...}; 9. Z. {...}; 10. Z. {...}; 11. Z. {...}; 12. Znj. {...}. Këto të fundit janë emëruar në vitin 2022 dhe nuk kanë plotësuar periudhën trevjeçare të vlerësimit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij me botimin në faqen zyrtare të internetit, në kushtet e një akti me natyrë kolektive.

Faleminderit!

Në rast se keni pyetje për sqarim.

Naureda Llagami: Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në miratimin e listës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen e sotshme.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor